

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5622
E mërkurë, 7 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

Kosova vendos masë mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KANCELARI I AUSTRISË, SEBASTIAN KURZ, KA VIZITUAR TË MARTËN SHTETIN E KOSOVËS, KU ËSHTË PRITUR NË TAKIME TË NDARA NGA PRESIDENTI HASHIM THAÇI DHE KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ



Kancelari Kurz i jep mbështetje idesë për korrigjimin e kufirit Kosovë - Serbi

Austria do ta mbështesë cilëndo marrëveshje të paqes që arrihet në kuadër të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duke mos përjashtuar as opsionet për korrigjimin e kufijve. Kështu ka deklaruar të martën në

Prishtinë kancelari austriak Sebastian Kurz, në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin e vendit, Hashim Thaçin. Kancelari Kurz ka bërë me dije se nuk do të ketë stabilitet në rajon dhe as perspektivë

evropiane pa një marrëveshje paqeje mes dy vendeve. Kurz ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave, me ç'rast ka treguar se ende ka shumë vende anëtare të BE-së që shprehin skepticizëm për këtë proces

AKTUALE

KURC NUK MUND TA SHNDRROJË KOSOVËN NË KURCISTAN E AS MACRON TË LEGALIZOJË MAKROTË E TË GJITHA PROFILEVE! F. 12



BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA



VESELI KËRKON NGA FRANCA MBËSHTETJEN PËR VIZAT DHE ANËTARËSIMIN NË INTERPOL F. 7

KONTRIBUTI I TË GJITHA KOMUNITETEVE, TEJET I RËNDËSISHME PËR LIGJET E FSK-së F. 6

EKONOMI

SHALA INSPEKTON ZBATIMIN E URDHËRESËS QË NDALON SHITJEN E DUHANIT DHE ALKOOLIT PËR TË MITURIT F. 9

KOSOVA DHE GREQIA DO TA VAZHDOJNË BASHKËPUNIMIN EKONOMIK DHE FINANCIAR F. 9

SPORT

FERONIKELI - PRISHTINA, 'BETEJA' PËR VENDIN E PARË F. 13

JUVE KËRKON SËRISH FITORE NDAJ UNITEDIT F. 13

Ofensiva diplomatike serbe të ndalet përmes dialogut të Brukselit

Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare i kanë ftuar institucionet e Kosovës që ofensivën e diplomacisë serbe kundër Republikës së Kosovës ta ndalin përmes dialogut të Brukselit. Profesori i së drejtës ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova duhet ta kërkojë respektimin e marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 ose të tërhiqet nga procesi për normalizim të raporteve në mes të dy shteteve. Kurse Jetlir Zyberaj, këshilltar i



zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm, Behgjet Pacolli, ka thënë se Kosova po përdor shumë instrumente diplomatike për ta kundërshtar lobimin e Serbisë kundër Kosovës



KMDLNj-ja: Gjendja shëndetësore e Sylejman Selimit nuk është e mirë

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kosova vendos masë mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja



Qeveria e Kosovës në mbledhjen mbajtur të martën ka vendosur masë mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe nga Bosnja dhe Hercegovina. Masa mbrojtëse nënkupton taksën prej 10 përqindësh të të gjitha produkteve që importohen në Kosovë dhe kanë për vend të origjinës Serbinë dhe Bosnjë dhe Hercegovinën

istratës publike, fuqizimi i shkëmbimit të përvojave me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe zhvillimi i burimeve në administratën publike.

Po në këtë mbledhje kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për inkasimin e mjeteve nga fondet e paalokuara në buxhetin e Kosovës nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës sipas gjendjes në fund të vitit 2018. Gjendja e këtyre fondeve pritet të jetë mbi 1.2 milion euro. Gjithashtu, është aprovuar edhe vendimi për ta miratuar kërkesën e Ministrisë së Financave për kursime, ndarje dhe transferime buxhetore ndërmjet kategorive të shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2018.

Është miratuar edhe vendimi preliminar për shpronësimin për interes publik të pronave të paluajtshme, sipas kërkesës së Komunes së Gjakovës, të cilat preken nga

ndërtimi i "Qarkores së Gjakovës". Miratimi i Qeverisë e ka marrë edhe vendimi për ndalimin e përdorimit të thëngjillit për ngrohjen e objekteve publike. Vendimi është bazuar nga përvojat e viteve të kaluara gjatë sezonit të dimrit që paraqiten me një shkallë të lartë të ndotjes së ajrit, që vjen edhe si pasojë e emetimit të gazrave në ajër nga mjetet e transportit, përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje dhe shënon përqendrim të ndotësve të ajrit në nivel të lartë. Me qëllim të zvogëlimit të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit, Qeveria synon që përmes shmangies së përdorimit të thëngjillit për ngrohje të objekteve publike, ta ulë nivelin e ndotjes.

Qeveria ka aprovuar propozimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që të aprovohen kërkesat e komunës së Mitrovicës së Veriut, të Ranillugut dhe të Kllokotit për tërheqje nga procesi i privatizimit dhe kthim në pronësi

të komunës të objekteve dhe pronave të paluajtshme me qëllim të realizimit të projekteve të interesit publik. Gjithashtu, me vendimin e miratuar në mbledhje të Qeverisë, Gentiana Islamaj është emëruar drejtoreshë e përgjithshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar, kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar rregullimin e statusit të përhershëm për të punësuarit në rezidencën presidenciale Ibrahim Rugova. Gjithashtu, me propozimin e kryeministrit është aprovuar plotësim-ndryshimi i Rregullores për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, me çka do t'i mundësojë që zëvendës kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme të ketë edhe tre këshilltarë politikë në përbërje të kabinetit të vet.

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për vendosjen e masës mbrojtëse për importin e të gjitha produkteve të prodhuara në Republikën e Serbisë dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Masa mbrojtëse nënkupton taksën prej dhjetë përqindësh të të gjitha produkteve që importohen në Kosovë dhe kanë për vend të origjinës Republikën e Serbisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinën. Përjashtim nga kjo masë do të bëjnë produktet e brendeve ndërkombëtare të prod-

huara në këto dy vende. Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Projektligjin për aderimin e Kosovës në Shkollën Rajonale të Administratës Publike - ReSPA. Qëllimi i Projektligjit është aderimi i Kosovës në këtë shkollë që do ta avancojë statusin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare me praninë e saj në forume shumë kombëtare.

ReSPA është organizatë me përfaqësues të Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Shqipërisë. Objektivi i ReSPA-s është përmirësimi i bashkëpunimit në sferën e admin-

Meta dekreton Bendon në krye të Shërbimit Informativ

TIRANË, 6 NËNTOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka dekretuar të martën Helidon Bendon në krye të Shërbimit Informativ Shtetëror (ShISH). Ky dekretim vjen më shumë se një vit pasi Bendo u emërua. "Në mbështetje të nenit 92, pika f, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 5, paragrafit 2, të Ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998 për Shërbimin Informativ Kombëtar", të ndryshuar me propozim të kryeministrit, dekretoj z. Helidon Bendo në detyrën e drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit", është thënë në njoftimin e



Presidentës së Shqipërisë. Helidon Bendo zëvendëson në këtë detyrë Visho Ajazin.

Sandër Lleshi votohet në Qeveri për postin e zëvendësministrit të Brendshëm

TIRANË, 6 NËNTOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka postuar të martën në llogarinë e vet në "Instagram" një fotografi me gjeneralin Sandër Lleshin. "Me drejtuesin e ri të Punëve të Brendshme, gjeneral Sandër Lleshin pas mbledhjes së Qeverisë që vendosi emërimin e tij zëvendësministër i Brendshëm", ka shkruar ai.



Kryeministri Rama ka thënë se presidenti Ilir Meta ende nuk e ka thënë fjalën e fundit për dekretimin e Sandër Lleshit ministër të Brendshëm. "Do t'i japim edhe ca kohë që ta blujë, por edhe vetes për ta hedhur hapin e radhës. Nuk kam humbur besimin se presidenti nuk e ka thënë ende fjalën e fundit mbi këtë çështje", u shpreh kreu i Qeverisë.

Ofensiva diplomatike serbe të ndalet përmes dialogut të Brukselit



Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare kanë ftuar institucionet e Kosovës që ofensivën e diplomacisë serbe kundër Republikës së Kosovës ta ndalin përmes dialogut të Brukselit. Profesori i së drejtës ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova duhet ta kërkojë respektimin e marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 ose të tërhiqet nga procesi për normalizim të raporteve në mes të dy shteteve. Kurse Jetlir Zyberaj, këshilltar i zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm, Behgjet Pacolli, ka thënë se Kosova po përdor shumë instrumente diplomatike për ta kundërshtar lobimin e Serbisë kundër Kosovës

Serbisë përmes Brukselit që veprimet e tilla janë të papranueshme. Pra, në rastin më ekstrem, ndoshta do të duhej të hiqej dorë fare nga dialogu", ka thënë Hoti.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare ka treguar edhe arsyet pse Serbia pikërisht tani ka shtuar aktivitetet për të kundërshtuar Kosovën në arenën ndërkombëtare. "Iniciativa serbe lidhet me fazën e fundit të dialogut Kosovë - Serbi dhe çfarëdo lajmi për gjoja tërheqjen e njohjeve mund të ketë pasoja në dy drejtime. Së pari, në krijimin e rrethanave që vazhdojnë të sjellin konfuzion në bashkësinë ndërkombëtare dhe kjo u sjell pozicion të privilegjuar në negociatë, duke i bërë serbët të fuqishëm në argumentin e tyre se statusi i Kosovës është ende i pazgjithur. Dhe si rezultat i kësaj kërkesat e Serbisë në dialog do të ishin shumë më të mëdha", ka thënë Hoti.

Arsyeja e dytë, sipas tij, është pengimi i Kosovës në anëtarësim në organizata ndërkombëtare. "Së dyti, ofensiva e diplomacisë serbe lidhet me qëllimet e Kosovës për të aplikuar për anëtarësim në organizatat e ndryshme ndërkombëtare siç është Interpoli, ku së shpejti pritet votimi edhe në UNESCO, por edhe në organizata të tjera në të cilat Kosova synon të bëhet anëtare. Propaganda e tillë për gjoja tërheqjen e njohjeve do ta ndihmojë Serbinë që t'i arrijë këto objektiva", ka vlerësuar Hoti.

Ndërsa Jetlir Zyberaj, këshilltar i zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo ministri është duke përdorur shumë instrumente diplomatike për ta kundërshtar lobimin e Serbisë kundër Kosovës. Sipas tij, institucionet e Kosovës kanë strategji të qartë se si të ecet më tutje. "Republika e Kosovës ka marrëdhënie të mira me të gjitha shtetet që e kanë njohur Kosovën deri më tash. Po ashtu, Kosova dhe institucionet e saj zhvillojnë aktivitete të vazhdueshme edhe me shtete të cilat ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës dhe në këtë drejtim ekziston një strategji e qartë se si ecet më tutje", ka thënë Zyberaj.

Ndërsa subjektet opozitare kanë kërkuar seancë të jashtëzakonshme parlamentare për të diskutuar, siç kanë thënë ata, për dështimet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës. "Duke qenë se politika e jashtme e Kosovës është tërësisht e çakorduar me skandalet e fundit në politikën e jashtme të cilat kanë dëmtuar jashtëzakonisht imazhin e Kosovës në botë, dhe duke pasur parasysh mosfunksionimin normal të Kuvendit të Kosovës, grupi parlamentar i LDK-së dhe ai i LV-së kanë dorëzuar të martën kërkesën, me të cilën kërkojnë thirrjen e seancës së jashtëzakonshme me këtë pikë në rend të ditës: 'Debat parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës'", është

thënë në njoftimin e grupit parlamentar të LDK-së.

Në arsyetimin e kësaj kërkesë thuhet se prioritetet e politikës së jashtme, në vend se të jenë afatgjata, po ndryshohen për çdo ditë, duke krijuar kështu konfuzion dhe situata të papëlqyera para partnerëve tanë ndërkombëtarë, ku ndërprerja e procesit të njohjeve është vetëm një nga pasojat e kësaj politike të jashtme të çakorduar, të papërgatitur dhe të dëmshme për shtetin e Kosovës. "Po ashtu, duke qenë se ministri i Punëve të Jashtme nuk përgjigjet as në interesimet e deputetëve për çështje të politikës së jashtme, pasi ai shumë rrallë merr pjesë në seancat e Kuvendit, si dhe në pamundësi që deputetët dhe Komisioni Parlamentar që mbulon politikën e jashtme ta kryejnë detyrën e tyre si mbikëqyrës të ekzekutivit të vendit që merret me politikën e jashtme, kërkohet mbajtja e seancës së jashtëzakonshme", është thënë në këtë njoftim për media.

Seanca është kërkuar të mbahet më 16 nëntor në orën 10:00.

Ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić, së fundi ka deklaruar se Kosova është ankuar te bashkësia ndërkombëtare për veprimet e Serbisë. "Shqiptarët u ankuar te perëndimorët për mua dhe kërkojnë nga Perëndimi për t'i ndaluar këto veprime, sepse kjo po irriton shqiptarët dhe dialogun, ndërsa lobimi i tyre për njohje të reja dhe anëtarësim në organizatat ndërkombëtare janë në rregull", ka thënë Dačić për mediet serbe.

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË 6 NËNTOR - Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare kanë bërë me dije se ofensiva e fundit e diplomacisë serbe karshi shteteve që e kanë njohur Republikën e Kosovës duhet të ndalet përmes dialogut të Brukselit. Zyrtarët e politikës së jashtme të Kosovës kanë vlerësuar se Kosova po përdor instrumentet e nevojshme diplomatike për t'iu përgjigjur Serbisë, kurse opozita ka kërkuar seancë të jashtëzakonshme parlamentare për të diskutuar rreth politikës së jashtme.

Profesori i së drejtës ndërkombëtare në UP, Afrim Hoti, ka treguar për gazetën "Epokën e re" se pala e Kosovës përpjekjen e Serbisë për ta penguar Kosovën në arenën ndërkombëtare duhet

ta ngrehë urgjentisht në dialogun e Brukselit. "Më vjen keq që gjithmonë po jemi të vonuar në këtë drejtim. Mendoj se këtë politikë destruktive është dashur ta sanksionojmë në procesin e negociatave të Brukselit. Pra, është dashur që kjo çështje të diskutohet në tryezën e bisedimeve dhe të kërkohet ndërprerja e këtyre veprimeve", ka thënë Hoti. Madje, sipas tij, Kosova është dashur ta ndërpresë këtë dialog nëse Serbia nuk do të hiqte dorë prej veprimeve kundër Kosovës. "Ndoshta është dashur edhe të kërkohet ndërprerja e këtij procesi të dialogut derisa pala serbe nuk e respekton marrëveshjen e prillit të vitit 2013, ku palët marrin obligime që të mos pengojnë njëra-tjetrën në ecjen përpara. Në këtë drejtim duhet të riaktualizohet shumë shpejt kjo çështje në dialog dhe t'i bëhet me dije

Kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz, ka vizituar të martën shtetin e Kosovës, ku është pritur në takime të ndaj

Kancelari Kurz i jep mbështetje idesë p

Austria do ta mbështesë cilëndo marrëveshje të paqes që arrihet në kuadër të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duke mos përjashtuar as opsionet për korrëgjimin e kufijve. Kështu ka deklaruar të martën në Prishtinë kancelari austriak Sebastian Kurz në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin e vendit, Hashim Thaçin. Kancelari Kurz ka bërë me dije se nuk do të ketë stabilitet në rajon dhe as perspektivë evropiane pa një marrëveshje paqeje mes dy vendeve. Kurz ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave, me ç'rast ka treguar se ende ka shumë vende anëtare të BE-së që shprehin skepticizëm për këtë proces



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz, ka thënë të martën në Prishtinë se Vjena zyrtare do ta mbështesë çfarëdo marrëveshje të paqes që arrihet në kuadër të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duke mos përjashtuar as opsionet për korrëgjimin e kufijve. Ai ka bërë me dije se vetëm një marrëveshje paqeje mes dy vendeve do të mund t'i hapte rrugë anëtarësimit të tyre në Bashkimin Evropian. "Qeveria e Austrisë pajtohet me cilëndo marrëveshje e cila arrihet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Pra, jemi të bindur që nëse ia dalin të kenë marrëveshje,

askush nuk do të jetë kundër saj. Edhe nëse ajo është korrëgjim i kufijve dhe shkëmbim i territoreve, ajo do të mbështetet nga ne. Vetëm një marrëveshje paqeje mes dy vendeve do të mund t'i hapte rrugë anëtarësimit të tyre në Bashkimin Evropian", ka deklaruar kancelari Kurz në një konferencë të përbashkët me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Kancelari austriak, vendi i të cilit mban aktualisht presidencën e BE-së, ka thënë se nuk do të ketë stabilitet në rajon dhe as perspektivë evropiane pa një marrëveshje paqeje në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Zhvillimet pozitive në Kosovë dhe në tërë rajonin janë shumë me rëndësi për ne. Si kryesues i

presidencës së BE-së i kemi vendosur shtetet e Ballkanit Perëndimor në fokus, sepse dëshirojmë që si rajon të gjitha shtetet të kenë një perspektivë evropiane dhe i mbështesim të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor në këtë rrugë. Që të sigurohet paqe, liri dhe siguri në mënyrë afatgjatë dhe të qëndrueshme në Ballkan është i rëndësishëm një dialog i suksesshëm ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe përmbyllja e suksesshme e këtij dialogu me një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", është shprehur kancelari Kurz, duke kërkuar nga qytetarët e Kosovës që t'i përkrahin përpjekjet e lidershit për forcimin e paqes në rajon. "Pa një marrëveshje

paqeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk do të ketë bashkëjetesë paqësore, stabilitet në rajon dhe nuk do të ketë as perspektivë evropiane. Prandaj, kam besim të madh në përpjekjet që janë duke u bërë këtu", ka thënë Kurz.

Kancelari austriak Sebastian Kurz ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, me ç'rast ka treguar se ende ka shumë vende anëtare të Bashkimit Evropian që shprehin skepticizëm për këtë proces. Kurz ka shprehur skepticizmin e tij edhe për krijimin e ushtrisë së Kosovës. "Sa i përket idesë së ushtrisë së Kosovës, jemi shumë skeptikë. Rajonit i duhen masa që çojnë në sta-

bilitet dhe jo në destabilitet", ka theksuar Kurz.

Thaçi: Vizita e kancelarit Kurz, impuls i ri për lidershpin e dy vendeve që të lëvizin drejt marrëveshjes paqësore

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka falënderuar kancelarin Kurz për mbështetjen që Austria po i jep Kosovës në marrëdhëniet bilaterale dhe në arenën ndërkombëtare. "Austria është duke vazhduar udhëheqjen e BE-së si kryesuese e radhës dhe gjatë gjithë kësaj periudhe ka bërë përpjekje për ta promovuar perspektivën evropiane të shteteve të



Tahiri: Kurz e Mogherini me lehtësi angazhohen për prekje kufijsh

Prishtinë, 6 nëntor - Ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri, e cila për disa vite ka qenë kryenegociatore e Kosovës në bisedimet teknike me Serbinë, ka komentuar deklaratën e kancelarit austriak Sebastian Kurz, i cili në një konferencë për medie në Prishtinë tha se

Austria dhe BE-ja mbështesin korrëgjimin e kufirit me Serbinë. Tahiri ka thënë se gjenerata e re e politikanëve evropianë, si Sebastian Kurz e Federica Mogherini, me lehtësi të padurueshme angazhohen për prekje kufijsh. Sipas saj, ata kanë qenë fëmijë

apo moshë adoleshente kur nisën luftërat e përgjakshme të Serbisë kundër Kosovës, Bosnjës dhe Kroacisë. "Gjenerata e re e politikanëve evropianë, si Kurz e Mogherini, me lehtësi të padurueshme angazhohen për prekje kufijsh, sepse nuk i kanë

parë as përjetuar luftërat dhe gjenocidet ndaj shqiptarëve dhe të tjerëve në Ballkan. Ata kanë qenë fëmijë apo moshë adoleshente kur nisën luftërat e përgjakshme të Serbisë kundër Kosovës, Bosnjës dhe Kroacisë", ka shkruar Tahiri në llogarinë e saj në "Facebook".



ra nga presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj

Ër korrigjimin e kufirit Kosovë - Serbi



të lëvizin drejt marrëveshjes paqësore. "Kosova ka ndërtuar raporte fqinjësore të mira me të gjitha shtetet fqinje. Po mundohemi maksimalisht që të ndërtojmë raporte korrekte edhe me Serbinë. Fatkeqësisht, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Përkundër këtij fakti, Kosova mbetet thellësisht e përkushtuar për dialogun me Serbinë, për arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse, që nënkupton normalizimin e plotë të marrëdhënieve dhe pajtimin, që nënkupton njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara", ka thënë presidenti Thaçi. Ai është shprehur i bindur se marrëveshja gjithëpërfshirëse me njohje reciproke mes Kosovës dhe Serbisë do të sjellë paqe të qëndrueshme në mes dy vendeve, të mira për të dy popujt, por edhe më tepër paqe dhe stabilitet për tërë Ballkanin Perëndimor dhe të ardhme të sigurt evropiane. Presidenti Thaçi e ka falënderuar kancelarin Kurz për mbështetjen e tij personale dhe të Austrisë në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol dhe organi-

zata të tjera ndërkombëtare, por edhe për përkushtimin e tij që qytetarët ta gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë në Zonën Shengen.

Haradinaj: Austria është mike e madhe e Kosovës dhe mbështetëse e fuqishme

Në kuadër të vizitës së tij në Kosovë, kancelari austriak Sebastian Kurz është pritur në takim edhe nga kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike në Kosovë dhe rajon. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj e ka njoftuar kancelarin Kurz për prioritetet e Qeverisë së Kosovës, për zhvillimin ekonomik, për agjendën e reformave evropiane, për forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit, si dhe për finalizimin e procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili do t'i kontribuonte stabilitetit ndërmjet dy vendeve. Haradinaj ka kërkuar ndihmën e shtetit austriak për çështjen e liberalizimit të vizave dhe për anëtarësimin e Kosovës në organizata të rëndësishme ndërkombëtare. Kryeministri ka falënderuar

kancelarin për përkrahjen që Austria i ka dhënë Kosovës në të gjitha etapat e shtetndërtimit. "Austria është vend mik. Ajo i ka dhënë Kosovës mbështetje të vazhdueshme në të gjitha proceset e rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar vendi", ka thënë Haradinaj.

Ndërsa kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz, ka thënë se vizita e tij në Kosovë është ndjenjë e mirë. "Siç e dini, ne e kemi kryesimin e Bashkimit Evropian dhe një nga synimet tona kryesore është që ta mbështesim rajonin dhe vendet e Ballkanit dhe ta mbështesim perspektivën tuaj evropiane dhe për këtë arsye unë kërkoj nga populli i Kosovës që ta mbështesë dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit, sepse mendoj se rezultat i suksesshëm i këtij dialogu është baza e perspektivës suaj evropiane dhe, po ashtu, një mundësi që të jetojmë së bashku në paqe dhe stabilitet, këtu në rajon", ka theksuar kancelari austriak. Kancelari Kurz ka bërë me dije se Austria është mbështetëse e fuqishme e Kosovës. Ai ka thënë se Austria është një nga shtetet më kontribuuese në Kosovë si dhe një nga investueset më të mëdha.

Ballkanit Perëndimor. Kosova është shteti më pro evropian në rajon dhe e kemi bërë të qartë vizionin tonë për anëtarësim në BE dhe NATO. Prandaj, puna dhe angazhimi ynë për arritjen e këtyre qëllimeve mbeten konsistente. Kjo është arsyeja që ne duhet të punojmë me përkushtim për t'i përmbyllur reformat e brendshme, në ekonomi, drejtësi, edukim, shëndetësi dhe në qeverisje të mirë", është shprehur Thaçi, duke shtuar se marrëdhëniet e mira fqinjësore janë kushti thelbësor në kontekst të integriteteve euroatlantike.

Ai ka thënë se vizita e kancelarit Kurz në Kosovë dhe në Serbi shpreson se do të jetë impuls i ri për lidhshpini e dy vendeve që



Murati: Mesazhet e kancelarit austriak Sebastian Kurz ishin të qarta

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Hulumentuesi i lartë i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Artan Murati, e ka komentuar vizitën e kancelarit austriak Sebastian Kurz në Kosovë, duke thënë se mesazhet e tij ishin të qarta. Murati ka theksuar se pas deklarimeve të

kancelarit Kurz, se disa shtete ende shprehin skepticizëm për liberalizimin e vizave, institucionet e Kosovës dhe drejtuesit e tyre duhet t'ua përmirësojnë jetën e qytetarëve. Sipas tij, lobimi kryen punë, por jo sa veprimet konkrete për rend, ligj dhe mirëqenie sociale.

"Mesazhet e kancelarit austriak Sebastian Kurz ishin të qarta: shumë shtete të BE-së kanë skepticizëm edhe për ekzistimin (të ardhmen) e BE-së, e lëre më për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ajo çfarë duhet të bëjmë tani është ta përmirësojmë jetën e qyte-

tarëve tanë, t'u ofrojmë jetë të dinjitetshme, arsim cilësor, shëndetësi funksionale, siguri për jetë dhe ekzistencë. Kjo është detyrë e përbashkët. Lobimi kryen punë, por jo sa veprimet konkrete për rend, ligj dhe mirëqenie sociale", ka thënë Murati.



Kontributi i të gjitha komuniteteve, tejet i rëndësishme për ligjet e FSK-së

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka mbajtur të martën në Prizren dëgjim publik rreth pakos së Projektligjeve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Në hapje të këtij dëgjimi Adelina Hasani nga KDI-ja ka theksuar se është bërë më shumë se një muaj që në Kuvendin e Kosovës ka shkuar pakoja e tri projektligjeve për FSK-në e cila ka kaluar në shqyrtim të parë dhe se organizimi i këtij dëgjimi publik bëhet me qëllim që trajtimi dhe diskutimi i pakos së tri projektligjeve të jetë sa më gjithëpërfshirës.

Kurse Haxhi Shala, deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Nismës Socialdemokrate, njëherësh kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme, ka potencuar se pas miratimit të pakos së ligjeve në Kuvend komisioni që ai drejton është në fazën e amendamentimit të këtyre ligjeve. "FSK-ja është

institucion kushtetues dhe kjo pako ligjore vetëm sa e avancoi rolin e FSK-së. Duke e ditur rëndësinë e këtyre ligjeve për ne është shumë me rëndësi t'i marrim mendimet e qytetarëve dhe të gjithë aktorëve të rëndësishëm në këtë proces", ka thënë Shala, sipas të cilit, në momentin që miratohen këto ligje, Kosova do të bëhet me ushtri pavarësisht se emri nuk do t'i ndërrohet.

Kurse zëvendëskryetari i këtij komisioni, deputeti nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka theksuar se komisioni po bën punë të mirë në mbajtjen e këtyre dëgjimeve publike në këtë fazë për shkak të rëndësisë që kanë këto ligje. "Kjo pako është shumë e rëndësishme jo vetëm për FSK-në, por edhe për të gjithë popullin e Kosovës. Është shumë mirë që kemi ardhur deri në këtë fazë që tanimë i kemi në Kuvend dhe po i trajtojmë këto ligje.

FSK-ja nuk i përket vetëm një etnie, por është e të gjithë qytetarëve dhe në mbrojtje të të gjithë qytetarëve", ka shtuar ai. Anëtar i tjetër i këtij komisioni, deputeti nga radhët e PDK-së, Fatmir Xhelili, ka potencuar se është shumë e rëndësishme që



FSK-ja tash ta avancojë rolin e saj pasi ka punuar shumë që të përgatitet për transformimin dhe avancimin e rolit në mbrojtje të qytetarëve të Republikës së Kosovës, gjithmonë në bashkëpunim me aleatët ndërkombëtarë të shtetit të Kosovës. Po ashtu, shtoi se FSK-ja është e hapur për të gjitha komunitetet që bashkëjetojnë në

Kosovë. Gjatë diskutimit pjesëmarrësit në këtë dëgjim publik nga organizatat e shoqërisë civile si dhe përfaqësuesit nga të gjitha grupet e komuniteteve të cilët jetojnë në Komunën e Prizrenit drejtuan pyetje dhe dhanë komente për ligjet para anëtarëve të komisionit parlamentar. Po ashtu, deputetët iu përgjigjën interesimit të

pjesëmarrësve lidhur me çështjet që ngrehën karshi këtyre ligjeve.

Ky dëgjim publik u organizua në kuadër të projektit për përkrahje të hulumtimeve parlamentare në Kosovë, që mbështetet nga USAID-i. Qëllimi i këtij projekti është që përmes hulumtimeve parlamentare të rritet cilësia e ligjeve në vend.

Përurohët çerdhja në Duhël të Suharekës

SUHAREKË, 6 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, kanë përuarur të martën çerdhen "Flutura", e cila do të funksionojë brenda hapësirës së Shkollës së Mesme të Ulët "Sadri Duhla" në fshatin Duhël të Suharekës. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka uruar të gjithë banorët e kësaj ane dhe ka thënë se është kënaqësi e veçantë përuimi i një objekti i cili do të shërbejë për edukimin e fëmijëve në moshë të hershme. Ministri ka theksuar se ndërtimi i çerdheve të reja, krijimi i mundësive për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, si dhe zgjerimi i infrastrukturës shkollore kudo në Kosovë, është një dëshmi se çdo ditë e më shumë arsimit po bëhet prioritet në Kosovë.

Ministri Bytyqi ka falënderuar mësimdhënësit për punën e palodhshme për edukimin e fëmijëve tanë, ndërsa ka thënë se pro-



fesioni i mësimdhënësit është më shumë sesa profesion, pra është një detyrë e shenjtë. Duke folur për prioritetet që i ka vënë Ministria për ngritjen e cilësisë në arsim, ministri Bytyqi ka theksuar nevojën që të gjithë së bashku të punojmë për të siguruar edukim më të mirë për fëmijët tanë. Në vazhdim ministri Bytyqi ka pohuar se si përgjegjës të arsimit dhe si mësimdhënës kemi obligim ta zbulojmë talentin e nxënësve. "Nëse nuk jemi në nivelin e përgjegjësive, ne do të kemi problem t'i zbulojmë talentet e fëmijët tanë, por edhe mund t'ua dëmtojmë talentin. Prandaj, është kërkesë e jona që të punojmë për ta ngritur standardin e cilësisë në arsim", ka thënë ai.

Ministri Bytyqi ka shtuar se të rinjtë janë pasuria jonë dhe ata kanë nevojë për një edukim të mirë që të sigurojmë jo vetëm të ardhmen e tyre, por edhe të ardhmen e vendit tonë.

Ministri Mustafa dhe komandanti i KFOR-it flasin për sigurinë në Kosovë

PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka pritur të martën në takim të rregullt komandantin e KFOR-it në Kosovë, Salvatore Cuoci. Të dy bashkëbiseduesit

diskutuan për gjendjen e sigurisë në vend, në veçanti për sigurinë përgjatë kufijve dhe në përgjithësi u vlerësua se gjendja e sigurisë në Kosovë është e qetë dhe stabile. Në këtë takim u vlerësua se

komunikimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe KFOR-it është i mirë dhe se duhet të punohet edhe më shumë që të avancohet ky komunikim. Ministri Mustafa ka falënderuar komandantin

e KFOR-it për përkrahjen e dhënë për institucionet e sigurisë të Republikës së Kosovës, gjë që është me rëndësi të madhe për sigurinë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.



KMDLNj-ja: Gjendja shëndetësore e Sylejman Selimit nuk është e mirë

Monitorues të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj-së) kanë vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë, ku po mbahet në paraburgim ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi. Sipas KMDLNj-së, gjendja shëndetësore e Sylejman Selimit nuk është e mirë dhe ajo mbahet nën kontroll me një terapi të përditshme për shkak të dhimbjeve të mëdha të kokës nga migrena sikur edhe për shkak të problemeve reumatike



për faktin se Gjykata Supreme më shumë se pesë (5 muaj) nuk e zbaton rekomandimin dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, si autoritet suprem i drejtësisë në Kosovë. Për këtë arsye, i dënuari Sylejman Selimi dyshon se prapa vendimit jolirues të Panelit për Lirim me Kusht dhe prapa refuzimit të zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës është një ndërhyrje e faktorit politik vendor dhe ndërkombëtar duke mos përmendur emra të individëve apo institucioneve që qëndrojnë prapa këtyre ndërhyrjeve", është bërë me dije në komunikatën e KMDLNj-së.

KMDLNj-ja ka njoftuar se pasi ta ketë në disponim tërë materialin gjyqësor për rastin e Sylejman Selimit do të dalë me një raport i cili do t'i evidentojë shkeljet e mundshme, pas të cilave do të kërkojë përgjegjësi ndaj atyre që kanë bërë shkelje, nëse ato dëshmojnë.

Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi, javën e kaluar i ka dërguar një letër drejtuar avokatit Tomë Gashi, në të cilën ka bërë me dije se ka marrë vendim që tash e tutje të mos ketë përfaqësim ligjor pasi, siç thotë ai, procesi kundër tij është i montuar nga politikanët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në letërën e shkruar me dorë, Selimi thotë se padrejtësinë ndaj tij do ta dëshmojë koha dhe se ata që kanë marrë pjesë në këtë montim politik, duke ndërhyrë në drejtësi, një ditë kanë për t'u turpëruar para familjeve të tyre dhe para qytetarëve të këtij vendi.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Monitorues të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj-së) në kuadër të mandatit që e kanë dhe në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me Ministrinë e Drejtësisë më 5 nëntor kanë vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë, ku po mbahet në paraburgim ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi. Sipas një njoftimi të KMDLNj-së, monitoruesit fillimisht janë takuar me drejtorin e Qendrës Korrektuese në Dubravë, Jeton Neziraj, pastaj kanë vazhduar monitorimin e objekteve të synuara dhe takim me të dënuar dhe të paraburgosur që kishin kërkuar të vizitohen nga KMDLNj-ja. "Gjatë kësaj vizite monitoruese të KMDLNj-së vizituan Sylejman Selimin, me të cilin biseduan për gjendjen shëndetësore që e ka dhe zhvillimet e fundit për çka Sylejman Selimi është deklaruar publikisht, duke pohuar se ndaj tij po bëhen shkelje flagrante të të drejtave të personave të privuar nga liria e që hyjnë në kompetencat e KMDLNj-së, organizatë për të

drejtat e njeriut, për faktin se edhe të privuarit nga liria, ndonëse janë të privuar nga disa të drejta (të rregulluara me ligjet në fuqi), nuk janë të privuar nga të drejtat e tjera e që respektohen në të gjitha shtetet dhe që janë të rregulluara me LESP-in. Gjendja shëndetësore e të dënuarit Sylejman Selimi nuk është e mirë dhe ajo mbahet nën kontroll me një terapi të përditshme për shkak të dhimbjeve të mëdha të kokës nga migrena sikur edhe për shkak të problemeve reumatike", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

Gjatë vizitës së KMDLNj-së, monitorues të kësaj organizate kishin qasje në "arsenalin" e barërave që përdorte Sylejman Selimi sikur që u vërtetuan se vetëm me injeksione të qetësuesve, përkohësisht mbahej nën kontroll kokëdhembja e tij. "Përkundër kësaj gjendjeje shëndetësore, Sylejman Selimi i deklaroi KMDLNj-së se nuk kërkon trajtim të veçantë shëndetësor dhe se ka parasysh mundësitë që ofrohen në QKD për trajtim shëndetësor. Po ashtu, Sylejman Selimi i ka deklaruar KMDLNj-së se është refuzuar kërkesa e tij për lirim të parakohshëm nga paneli për

lirim me kusht, ndonëse i ka plotësuar kushtet e parapara; ka vuajtur 2/3 të dënimit, më shumë se 1 vit është shfrytëzues i përfitimeve (vikendeve në shtëpi), nuk ka asnjë vërejtje nga stafi dhe ka gjendjen shëndetësore të përkeqësuar", është thënë në këtë komunikatë.

Gjatë takimit me monitoruesit e KMDLNj-së, Sylejman Selimi ka shfaqur pakënaqësi të madhe shkaku se Gjykata Supreme nuk e ka zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e cila ka gjetur shkelje të procedurës dhe ka kërkuar rishqyrtim të lëndës. "Për këtë arsye, i dënuari Sylejman Selimi i ka deklaruar KMDLNj-së se mbahet kundërligjshëm më shumë se pesë (5 muaj), pa vendim të gjykatës dhe se përmes shkeljes së ligjit atij i shkelen të drejtat elementare të njeriut. Për ta

vërtetuar këtë thotë se në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës janë shkarkuar apo dorëhequr dy presidentë të Kosovës me një procedurë shumë të përshpejtuar.

I dënuari Sylejman Selimi thotë se nëse gjykata përkatëse merr vendim për hetime ndaj atij duhet t'i ndërrohet statusi, nga i dënuar në të paraburgosur dhe jo të mbahet në vuajtje të dënimit, pa vendim të gjykatës, pas një procesi të montuar politik, me vetëm një dëshmitar dhe pa e ditur identitetin e personit se, kinse, është rrahur, që qenka nga Shipoli por, pa emër dhe mbiemër. Këtë proces dhe këtë gjykim e quan të pashembullt dhe pa asnjë të ngjashëm në praktikën e drejtësisë ndërkombëtare dhe vendore. Sylejman Selimi e konsideron veten të përjashtuar nga çdo mbrojtje

Veseli kërkon nga Franca mbështetjen për vizat dhe anëtarësimin në Interpol

PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të martën në takim drejtoreshën për Evropën në Ministrinë për Evropën dhe Punëve të Jashtme të Francës, Florence Mangin, me të cilën ka diskutuar për thellimin e ndërmjet Kosovës dhe Francës, për zhvillimet politike në vend dhe rajon, me theks të veçantë për hapat që ka bërë Kosova në rrugën e saj të integritit euroatlantik e të anëtarësimin në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Veseli e ka falënderuar Mangin dhe nëpërmjet saj, shtetin francez për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Kosovës në të gjitha fushat dhe proceset. Kreu i Kuvendit u fokusua në agjendën euroatlantike të Republikës së Kosovës dhe nevojën e përkrah-

jes së mëtejme nga vendet mike si Franca. Veseli ka theksuar se Franca e ka mbështetur Kosovën në rrugën e saj evropiane dhe përkrahja e Parisit zyrtar në fazën finale të liberalizimit të vizave është shumë me rëndësi, por po ashtu i kërkoj edhe mbështetjen e Francës për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. "Kosova i ka përmbytur të gjitha kriteret e kërkuara për liberalizim të vizave dhe për këtë ka marrë vlerësimin e nevojshëm si nga Komisioni Evropian, po ashtu edhe nga Parlamenti Evropian. Tani presim një veprim të qartë nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Do ta vazhdojmë rrugën tonë të reformave në agjendën evropiane. Adresa e Kosovës është Bashkimi Evropian dhe NATO dhe ne do ta ndjekim këtë rrugëtim", ka thënë



kryeparlamentari Veseli. Ndërsa zyrtarja e lartë franceze, Florence Mangin, ka theksuar se

do ta përkrahin rrugëtimin evropian të Kosovës, anëtarësimin në Interpol si dhe do të

angazhohen për rritjen e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve.

Bëhet prezantimi i projektit për ndërtimin e shkollave në kryeqytet

PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER) - Në Komunën e Prishtinës të martën është bërë prezantimi i projektit për ndërtimin e shkollave Private Finance Initiative (PFI).

Kompanitë e interesuara janë informuar për projektin në përgjithësi, për funksionimin e atyre shkollave, për termat e projektit dhe për ndarjen e rez- iqeve. Po ashtu, ato janë informuar për projektet konceptuale, kërkesat e projektimit dhe ndërtimit, shërbimet dhe kërkesat e mirëmbajtës si dhe për fazat deri në realizimin e projektit. Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) është mandatuar nga Komuna e Prishtinës si këshilltari kryesor i

transaksionit.

IFC-ja do të punojë në strukturimin e transaksionit me partneritet publiko-privat dhe do ta ndihmojë Komunën e Prishtinës për ekzekutimin e një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues të ofertimit për përzgjedhjen e investitorit privat. Gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të këtij viti do të bëhet promovimi dhe strukturimi i transaksionit, përderisa në janar të vitit 2019 do të hyjnë në procesin e parakualifikimit. Fillimi i procedurave tenderuese do të bëhet në shkurt të vitit 2019, kurse nënshkrimi i kontratës me kompaninë fituese parashihet të bëhet në muajin maj të po këtij viti.



Nderohen dëshmorët Toni, Mici, Hajrizi, Haliti dhe Ymeri

RAHOVEC, 6 NËNTOR (ER) - Me rastin e 20-vjetorit të rënies së dëshmorëve Xhelal Hajda-Toni, Selajdin Mullabazi-Mici nga Rahoveci dhe Hamdi Hajrizi, Bektesh Haliti dhe Nezir Ymeri nga Komuna e Vushtrrisë, janë bërë homazhe dhe nderime të përmendoret e Tonicit dhe Micit, te vendi i rënies së tyre mbi fshatin Optrushë dhe varrezat e dësh-

morëve në qytetin e Rahovecit. Në homazhe dhe nderime të pranishëm ishin shumë qytetarë nga Komuna e Rahovecit, po ashtu edhe nga Komuna e Vushtrrisë si dhe kryetari i komunës, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë, familjarë dhe bashkëluftëtarë të dëshmorëve. Në fjalimin e mbajtur te vendi i rënies mbi fshatin Optrushë, kryetari Latifi e ka

çmuar lart jetën dhe veprën e të rënëve të 6 nëntorit të vitit 1998.

Në 20-vjetorin e rënies së heronjve Xhelal Hajda-Toni dhe Selajdin Mullabazi-Mici nga qyteti i Rahovecit në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit, Posta e Kosovës ka bërë përrurimin e pullave postare për heronjtë Toni dhe Mici.



Bekim Jashari: Nuk ka investim më të mirë sesa në bujqësi

SKENDERAJ, 6 NËNTOR (ER) - Të martën në Komunën e Skenderajt janë nënshkruar 14 kontrata me fermerët e kësaj komune, ku secili prej tyre përfiton një ari serrë për mbjellje të kulturave të ndryshme bujqësore. Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se ky investim është më së i qëlluar pasi, sipas tij, ngritja e një serre është e barasvler- shme me hapje të një vendi të ri të punës.

Jashari ka theksuar se nuk ka investim më të mirë sesa në bujqësi. "Nuk ka investim më të mirë sesa në bujqësi. Këtë po e bëjmë çdo ditë, për t'u dhënë mundësi punëtorëve të vyeshëm që nëpërmjet subvencioneve ata të zhvillohen dhe të rriten si fermerë. Sot kemi nënshkruar 14 kontratat me fermerët e Komunës së Skenderajt, ku secili prej tyre përfiton 100 m2 apo 1 ari serrë për mbjellje të kulturave të

ndryshme bujqësore. Ky investim është më së i qëlluar, pasi këtë unë e kuptoj kësaj: ngritja e një serre e barasvler- shme me hapje të një vendi të ri të punës. Pak ditë më parë kemi mbështetur blektorët me makina mjelëse dhe bletarët me koshere dhe pajisje të tjera të nevojshme. Duke i uruar fermerët përfitues, dua që ata pas një kohe t'i kenë shtuar përfitimet dhe punën!", ka thënë Jashari.

Policia e rajonit të Mitrovicës shqiptoi 40 gjoba për këmbësorë

MITROVICË, 6 NËNTOR (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë rrugore dhe uljes së aksidenteve, ka ndër- marrë masa për zbatim të lig- jeve të fushës së trafikut rrugor. Në këtë drejtim policia ka njoftuar se ka shqiptuar 40 gjoba për këmbësorë të cilët nuk kanë respektuar shenjat e komunikacionit. "Angazhimet e shtuara policore janë përqen- druar në rrugën nacionale Mitrovicë - Prishtinë, segmenti rrugor përgjatë fshatrave Lumë i Madh, Stanovc i Epërm dhe Stanovc i Poshtëm, zonë kjo e identifikuar me rrezikshmëri për këmbësorët që nuk shfrytë- zojnë nënkallimet, ku si pasojë ka pasur edhe aksidente me fatalitet. Në mbështetje dhe zbatim të masave të shtuara, përveç Njësisë së Trafikut Rajonal, me plan veprimi konkret është duke kontribuar edhe Stacioni Policor Vushtri, ku për çështjen e sigurisë së



këmbësorëve dhe shfrytëzimin e nënkallimeve ka mbajtur tri takime me banorët e tri fsha- trave të sipërpërmendura, ndërsa në kuadër të veprimeve konkrete ka shtuar praninë policore në kuadër të sektorit përkatës që mbulon këta fsha- tra. Për pjesëmarrësit që bien ndesh me rregullat që parasheh Ligji në trafik, po shqiptohen masa ndëshkuese ligjore, me qëllim të parandalimit të rasteve të aksidenteve. Në dy javët që lamë pas, nga njësitë në terren në zonën e fshatrave të lartcekura të Vushtrrisë, për kalim të rrugës së këmbësorëve në zona ku nuk është e lejuar, janë shqiptuar mbi 40 gjoba për këmbësorë", është thënë në njoftimin e policisë.

Hapen 600 vende të reja të punës në sektorin e tekstilit në Gjakovë

JUNIK, 6 NËNTOR (ER) - Komuna e Junikut përmes një njoftimi për media ka njoftuar se kjo komunë, në bashkëpunim me Zyrën e

Punësimit në Junik dhe Françeska Kosovë, kanë hapur 600 vende të punës në sektorin e tekstilit. "Vendi i punësimit do të jetë në

Gjakovë, ku do të përfshihet trans- porti falas për të punësuarit nga Juniku dhe Deçani. Për më shumë informata paraqituni në Zyrën e

Punësimit në Komunën e Junikut apo në numrin e telefonit: 0390- 390 706", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Junikut.



Shala inspekton zbatimin e urdhëresës që ndalon shitjen e duhanit dhe alkoolit për të miturit

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka dalë të martën në terren për ta parë nga afër zbatimin e ligjit për ndalimin e shitjes së duhanit dhe pijeve alkoolike për të miturit. Në rast të moszbatimit të këtij ligji, ministri Shala ka paralajmëruar se do të ketë gjoba që i parasheh ligji



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka dalë të martën në terren për ta parë nga afër implementimin e nenit 15 të Ligjit Nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit, që ndalon shitjen e duhanit dhe pijeve alkoolike për personat nën moshën 18 vjeç. Bashkë me Inspektoratin e Tregut, ministri Shala ka qenë në një market dhe

ka parë nga afër vendosjen e shenjave që tregojnë se ndalohet shitja për të miturit. "Në mungesë të implementimit të ligjit në tërësi për mbrojtjen e konsumatorit, respektivisht nenit 15, që përcakton që duhani dhe pijet alkoolike janë të ndaluara të shiten dhe të shërbehen për të miturit nën moshën 18-vjeçare, unë dje kam marrë një urdhëresë me të cilin kam urdhëruar Inspektoratin e Tregut të MTI-së që të implementohet në për-

pikëri ligji. Vizita ime ka të bëjë me zbatimin e këtij ligji në kompaninë 'Elkos', e cila e respekton këtë ligj dhe unë i falënderoj dhe i siguroj qytetarët e Kosovës, që në bashkëpunim me inspektoratet komunale do t'i rrisim inspektimet në të mirë të konsumatorit", ka theksuar ministri Shala.

Në rast të moszbatimit të këtij ligji, ministri Shala ka paralajmëruar se do të ketë gjoba që i parasheh ligji. "Dënimet janë të parapara me ligj dhe këto janë detaje që inspektorati i merr këto masa dhe ligji e përcakton që shitësi është i obliguar në rast kur dyshon, që përmes dokumentit të identifikimit ta shesë produktin", ka thënë Shala. Ministri ka bërë me dije se ky inspektim do t'i përfshijë të gjitha pikat shitëse në tërë territorin e Kosovës. "Vizita ime këtu ka të bëjë me një paralajmërim për të gjithë shitësit e tjerë që ta respektojnë nenin dhe ligjin në tërësi", ka thënë Shala. Selvete Abazi nga "Elkos" ka pohuar se ky vendim është i mirëpritur dhe do ta respektojë.



Kosova dhe Greqia do ta vazhdojnë bashkëpunimin ekonomik dhe financiar

PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të martën në takim një delegacion të shtetit të Greqisë, i kryesuar nga sekretari i përgjithshëm për çështjet ekonomike ndërkom-bëtare dhe bashkëpunim për zhvillim në Ministrinë e Punës së Jashtme të Greqisë, Ioannis Brachos. Në këtë takim të dyja palët diskutuan për shtimin e bashkëpunimit në fushën e ekonomisë dhe financave ndërmjet dy vendeve.

Ministri Hamza e ka njoftuar delegacionin grek për zhvillimet në Kosovë, me theks të veçantë për

menaxhimin e financave publike, si dhe për reformat fiskale që ka ndërmarrë dhe do të marrë Qeveria e Kosovës, të cilat mundësojnë dhe ndikojnë në krijimin e kushteve më të mira në të bërit biznes, si dhe tërheqjen e investitorëve të huaj në Kosovë.

Ndërsa sekretari i përgjithshëm për çështjet ekonomike ndërkom-bëtare dhe bashkëpunim për zhvillim në Ministrinë e Punës së Jashtme të Greqisë, Ioannis Brachos, ka falënderuar ministrin Bedri Hamza për pritjen dhe ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të shtetit grek për vazhdimin e



bashkëpunimit ndërinstitucional, sidomos në aspektin ekonomik dhe financiar.

Në këtë takim morën pjesë edhe shefja e zyrës së deritanishme të Greqisë në Prishtinë, Constantina

Athanasiadou dhe shefja e re e Greqisë në Prishtinë, Chrissy Aliferi. Me këtë rast, ministri Bedri Hamza ka falënderuar shëfën e deritanishme greke Athanasiadou për bashkëpunimin që ka pasur me institucionet e Kosovës, veçanërisht me Ministrinë e Financave. Po ashtu, ministri Hamza i ka shprehur mirëseardhje shëfës së re greke Aliferi dhe e ka siguruar atë për vazhdimin e bashkëpunimit të Ministrisë së Financave me Ambasadën e Greqisë në Prishtinë, sidomos në fushën e ekonomisë dhe të financave.

Përfaqësues të Bankës Botërore njoftohen me konceptin e qendrës së trajnimeve KOCME

PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER) - Ekipi i Bankës Botërore për Forcimin e Sistemit të Mbrojtjes Sociale dhe të Punës në Kosovë dhe të Gjetjes së Zgjidhjeve për Papunësinë e të Rinjve ka vizituar Klubin e Prodhuesve në kuadër të misionit të vet në Kosovë. Gjatë vizitës përfaqësuesit e Bankës Botërore u njoftuan për perceptimet e biznesit në lidhje me nevojat e punësim-it, si dhe për iniciativën e Klubit të Prodhuesve për themelimin e qendrës së trajnimeve KOCME. Klubi i Prodhuesve, si një ndër organizatat më të rëndësishme

të biznesit në Kosovë, i njoftoi përfaqësuesit e Bankës Botërore se puna e Klubit përqendrohet në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit të prodhimit. Kështu, Klubi së bashku me partnerët është duke punuar për krijimin e një programi të strukturuar për zhvillimin e aftësive të nevojshme të rinjve për t'u punësuar.

Qëllimi kryesor i KOCME-it do të jetë ngritja e kuadrove të reja profesionale për nevojat e kompanive në fushën e zhvillimit dhe trajnimit të aftësive të punonjësve, kërkimit dhe diza-

jnit të produkteve, konkurrencës në prodhim dhe inkuadrimit të praktikave më të mira globale në kuadër të mësim-nxënies.

Qendra e trajnimeve KOCME do të ndihmojë për krijimin e një mjedisi ku do të promovojë inovacion dhe do të luajë një rol të rëndësishëm për bërjen e Kosovës vend konkurrues për investime, me fokus për tërheqjen e investitorëve me potencialë eksportues.

Aktualisht, sektori i prodhimit ka mungesë të thellë të punëtorëve të kualifikuar, sidomos



në teknologjinë e ushqimit, punimin e drurit dhe të metalit,

si dhe në industrinë e tekstilit dhe atë të mekatronikës.

KURC NUK MUND TA SHNDËRROJË KOSOVËN NË KURCISTAN E AS MACRON TË LEGALIZOJË MAKROTË E TË GJITHA PROFILEVE!

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



Macron dhe Franca, Kurc dhe Austria: Për idetë e tij që dalin jashtë një qasjeje normale për zgjidhje të problemeve të pazgjidhura me shtetet fqinje, Hashim Thaçi i Parë, së pari kërkoi përkrahje nga presidenti i Austrisë për të cilin kufijtë e Kosovës e kanë kuptimin dhe rëndësinë e brekusheve të palara që domosdoshmërisht duhet t'i ndërrojë nëse nuk dëshiron të infektohet sikur edhe nga presidenti i Francës, Emanuel Macron, që besnikërisht po e përfillë dhe zbaton traditën e mbrojtësit të Serbisë. Edhe për të kufijtë e Kosovës e kanë kuptimin e një kondomi të shqyer i cili, në rastin më të keq, mund të prodhojë një shtatzëni të padëshiruar. Hashim Thaçi si, udhëheqës i bandës së katërshit (edhe kinezët e kishin bandën e katërshit) në përbërje me vëllanë e tij kombëtar, politik, moral e sidomos të biznesit e që quhet Behgjet Pacolli, së bashku me dy paterica funksionale, Edita Tahiri dhe Enver Hoxhaj, janë përgjegjës të kryesorë për këtë gjendje të krijuar dhe krijim të kushteve që Serbia, 20 vjet pas përfundimit të luftës ta kontestojë tërësinë territoriale të Kosovës në kohën kur sovranitetin e Kosovës e ka dhunuar deri në shkërdhyerje, që nga përfundimi i luftës e deri më sot. Hashim Thaçi i Parë, i shoqëruar me paterica si punë e Bekimit dhe disa këshilltarë, disa prej tyre bashkëpunëtorë të Serbisë dhe denoncues të atdhetarëve të cilët pastaj janë dënuar me dënime të rënda, pariparueshëm e ka dëmtuar Kosovën duke e vënë në licitacion Kosovën dhe duke u identifikuar si donator i territorit të Kosovës, pa asnjë kompensim, shtetit që për më shumë se një shekull ka ushtruar dhunë dhe gjenocid ndaj shqiptarëve, Serbisë shoviniste të Nikolla Pashiqit dhe Serbisë fashiste të Aleksandar Vuçiqit. Hashim

Thaçi i Parë nuk meriton vetëm përbuzje dhe injorim dhe nuk mjafton vetëm kërkesa për dorëheqje dhe as vetë dorëheqja që nuk e jep për së gjalli, por duhet të përballet me pasojat ligjore për të gjitha këto që i ka bërë dhe po i bënë, pa qenë i autorizuar nga askush. Përralla janë premtimet për bashkimin e Luginës së Preshevës pa dhënë asgjë sikur që janë përralla se Kosova do të pranohet nga Serbia dhe se do të integrohet në të gjitha mekanizmat ndërkombëtarë sikur të gjitha vendet normale të botës. E pse u dashka Kosova të vdesë nga dëshira të pranohet nga Serbia e cila nuk lë gur pa lëvizur për ta dëmtuar Kosovën dhe për ta bërë jofunksionale e që, në një masë të madhe e ka arritur, jo pse është e zonja, por se udhëheqësit tanë leshko dhe të paditur ia kanë mundësuar këtë dhe po ia vendosin topin në 11-metërshin e "finales së madhe", duke e lënë portën e Kosovës pa mbrojtje dhe të zbrazët, sikur që janë edhe kokat e tyre. Një ndër fatkeqësitë më të rënda që kanë mundur dhe e kanë goditur Kosovën është mundësia që i është dhënë Behgjet Pacollit të flasë në emër dhe për Kosovën sikur që edhe të jetë vendimarrës për procese që përmbajtësisht dhe, në disa raste pariparueshëm, e kanë dëmtuar Kosovën. Ky farë pehllivani qeveritar, në vend se të sigurojë njohje të reja për Kosovën, po shtyhet në rrena me Ivica Daçiqin se a e kanë tërhequr njohjen shtetet që e kanë pranuar më parë pavarësinë e Kosovës a jo?! Çfarë aktiviteti joproduktiv dhe rrënues që na vë në dyshim se ministër i cilit shtet në të vërtetë qenka ortaku i Thaçit nga diaspora. Edita Tahiri, si dëmtuese strategjike e buxhetit të Kosovës që edhe mund të riparohen por, në të njëjtën kohë, si dëmtuese e

madhe e interesave të Kosovës e që nuk riparohen, në vend se ta mbyllë gojën dhe të kalojë në radhët e Motrave të Nderit të Shën Terezës, ku deri në fund të jetës do të përballet me mëkatet dhe dhembjet që ua ka bërë qytetarëve të Kosovës, për çdo ditë lëshon pordhë të ftohta patriotike, madje duke e kritikuar edhe vetë kryeqëbërësin të cilit i ka shërbyer me besnikëri, për tradhti kombëtare, duke e përkrahur veten nga ky proces, pjesë aktive e të cilit ka qenë, deri në shkëlqimin nga kryeqëbërësi, i shndërruar në monark absolut. Enver Hoxhaj apo grof Minhauzeni i diplomacisë kosovare nuk ka lënë mjet pa përdorur për të mbetur në postin e kryediplomatit duke mashtruar për ditë e më shumë derisa në skenë doli një mashtrues edhe më i madh se ai, Behgjet Pacolli. Në kazanin ku janë gatuar gjellet më helmuese për Kosovën dhe qytetarët e saj, Enver Hoxhaj ka qenë aditiv që e ka fryrë gjellën sikur që furratë e lig i fryjnë bukët duke ua hequr kafshatën atyre që bukën e kanë artikullin më të shpeshtë për ushqim.

Një propozim për Kurcin dhe Macronin: Në vend se të merren me kufijtë e Kosovës duke ia mundësuar Serbisë të përfitojë territore në saje të atyre që e duan Kosovën sa edhe Luginën e Peshavarit e që është Banda e Katërshit, Kurc duhet të merret me kufijtë e Austrisë. Pasi qenka aq dorëlibër, le t'ia kthejë Korushkën Sllovenisë sikur edhe Tirollin Italisë. Këto territore janë marrë kundër vullnetit të Italisë dhe Sllovenisë pasi paraprakisht janë pushkatuar me mijëra dhe dhjetëra mijëra sllovenë dhe italianë. Apo, Franca që po gërryen në territorin e Kosovës për llogari të Serbisë, Vuçiqit dhe Thaçit, le ta njohë pavarësinë e Korsikës dhe të baskëve sikur edhe le t'ia

kthejë Strasburgun Gjermanisë ku, mbi 70 për qind të mbishkrimeve dhe toponimeve janë në gjuhën gjermane.

Kurci dhe Macro nuk mund ta identifikojnë Thaçin me Kosovën, qoftë ky i shoqëruar nga kondomë - patericat dhe "diplomatët e regjur bythëve nga Serbia", Behgjet Pacolli, Enver Hoxhaj dhe diplomatja për shërbime teknike, Edita Tahiri.

Për këto propozime që kufizohen me aventura të Tom Sojerit, përveç Bandës përcjellëse dhe patericave të kondomizuara, Hashim Thaçin nuk e përkrahë askush. Madje as Rada Trajkoviç dhe serbët e Graçanicës. Harrova që e përkrahë fuqishëm edhe amazona numër 1 e PDK-së, Ganimete Musliu apo këp(s)ulqja e kësaj partie. Ajo tha se Hashimin e kanë zili për faktin se qenka i pazëvendësueshëm. Pajtohem plotësisht Gane me ty për faktin se Hashimi është i pazëvendësueshëm në keqberje që po i bënë Kosovës. A ke pasur edhe të këtë vlerësim apo ke menduar ndryshe, kur ke deklaruar ashtu?!

Në partinë ku e ka bazën deleguese Hashim Thaçi, PDK-së, ka zëra, tash thuaja të izoluar që e kundërshtojnë idenë e Hashimit për kundërshtim të korrigjimit të kufijve dhe, në vend se kundërshtimi i parë dhe më i fuqishëm të ishte pikërisht i PDK-së, ata po mundohen ta mbrojnë duke e goditur bythëve (ku djegë por nuk dhembë) dhe duke ia ruajtur kokën e cila, që në fillim është dashur të goditet derisa kjo ide të largohet nga kjo kokë e çarë! Ndoshta, këta që po e përkrahin Hashim aq fuqishëm mendojnë se idetë e mëdha dalin nga bytha, të cilën po e godasin e jo nga koka të cilën po e kursejnë! Të gjithë jemi bërë peng i Bandës së Katërshit sikur edhe që ishte bërë peng Kina gjatë kohës së

Revolucionit Kulturor që tiranozohet nga Banda e Katërshit Kinez, fundi i së cilës ishte tragjik! Ai që ka hyrë në lojë për lëvizje të gurëve të mexhave, asnjëherë nuk është ndarë mirë, në të shumtën e rasteve kanë përfunduar tragjikisht. Thaçi me Bandën e Treshit (banditja Tahiri është defunksionalizuar) mund edhe të nënshkruaj një marrëveshje me Vuçiqin e që mund edhe të noterizohet nga Kurci i Austrisë dhe Macro i Francës mirëpo, siç shkruan Kimete Berisha, me këtë marrëveshje mund ta fshijnë guzicën. Hashimi, ndonëse fort shpesh po takohet me burrat e Serbisë si Vuçiqi, Daçiqi dhe Bërnabiqi, nuk e besoj se njeh gjuhën serbe në atë masë sa që ta përkthejë drejt këtë fjali të Kimetes andaj, si përkthyes i shkëlqyer mund të shërbejë Begja i cili, më mirë e kupton gjuhën serbe se gjuhën shqipe. Edhe Edita e di mirë serbishten kurse Enver Hoxhaj nuk është fort i kualifikuar për përkthime sikur që i mungon guzica për vendime të mëdha dhe të drejta prandaj e përdor guzicën e të tjerëve, në rastin konkret të Hashës prapa së cilës fshihet.

Anatomikisht, Kurcin nuk mund ta luftojmë me Hashim Thaçin kurse edhe ne e kemi një armë të kalibrit më të vogël me të cilën mund t'i kundërvihemi Kurcit. E kemi Pecin, Lulin apo Xhevdën, nuk ka fort rëndësi.

Macro i Francës lehtësisht mund të përballet me makro kosovarë që janë shumë aktivë edhe në vetë Francën. Prandaj na lini të lirë ta luftojmë krimin e organizuar dhe të paorganizuar sikur që edhe ju jeni të lirë dhe e keni detyrim ta luftoni krimin e organizuar me narkotikë dhe genie njerëzore në Bruksel. Cakun e keni edhe disa muaj në krye të mekanizmit që po e udhëheq politikën e BE-së, duke dhunuar qytetarët e Kosovës, së bashku me leshkot tanë politikë dhe jopolitikë!

(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /15/

Deklarata e Ahmet Dërgutit para prokurorit



**Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA**

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

Në mal kam një djal mixhe i cili asht largue per shkak ushtrije shkakun e mos dorëzimit te tij nuk e di. I pandehuri Tahir nuk me ka propozue me hy mua në komitetin central.

Mbi pyetjen e prokurorit publik i pandehuri thotë se: Unë s'kam marr pjesë në komitet vetem se letren kam que e kur e mora vesh se kjo punë qenka kundër popullit dhe pushtetit jam largue. Kur kam marr letren e dytë që e kam grisur kam shkue ne Rahovec e s'kam takue me Kadri dhe se kur jam kthye pastaj me Tahirin. Tahiri ndonji fjalë për situatën heren e parë s'me ka thanë gje, per te dytën herë ai me kallxoi une letren e grisa dhe nuk e kam qu. Letren Tahiri ma ka dhanë kur unë shkoja ne Rahovec per punë tjera te mijat. Mua një herë prej burgut me kanë lanë te lirë pse përfitova prej amnestije e tash me kanë kap prap dhe ndodhem i burgosun. Veç ditës që më dha letren Tahiri e qe une e grisa qe me kallxoi se kush defton vritet nuk me ka thenë heret e tjera, s'kam lajmru e për këtë gja, mbasi jam tut me fjalet e Tahirit qe me tha se ai që kallon vritet. Rifat Krasniqi tash dy ditë per para jam pamun në burg.

Kadri Minushi me ka kallxue per Ahmet Dërgutin, Gashin veten e vet që janë në Komitet. Programin e organizatës s'ma kanë dhanë as Tahiri e as tjetër kush. Tahiri veç fjalëve qe unë kam thënë më para tjera s'më ka thanë. Ata që janë në mal janë njerëz të kqi e ruajn kryet e vet. Sesi e ka pas emrin komiteti i Prizrenit, unë nuk e di se une posa mora vesh se komiteti i formuer ka pas qellim të keq jam larguar. Për radio sdi gjë as edhe per nfihma Radijen e di pasi eshte per Radio stranicë nuk di mbasi skam par. Sheh Muhedini e njoh e me kon[per fjalë skam pas e skam biseduar kurr me te. Kadri Minushi ka pas lidhje me Drenicë ose jo nuk e di. Kadrija se pari i kishte dergua Tahirit nj letër me anen e një komshiut tem, te cilen letër unë ja kam dorëzue grues së Tahirit ne shtepi ne kohë që Tahiri nuk ndodheshe aty. Tjetër letër ose send tjetër se kam marr e as nuk di.. Haxhi Faslliu qe me thoni

nuk e njof po ashtu edhe Ukë Sadikun nuk e njof por vetem e di per kete te fundit se ka qenë Nënprefekt i Rahovecit e tash ndodhet në mal. Fajtor per mue asht Tahir Deda qe m'ka mashtrua.

"VENDIM"

Me qenë se, koha kaloj vazhdimi i seancës gjyqësore lihet për nesër me datë 22/9.1945, ora 8 para dite dhe në kete menyëju njoftua të pandehurve, të cilët nën roje të sigurta u dërgun per ne burg.

Prizren, 21/9/1945

Sekretar; Mustafa Biçoku
Anëtari; Kolë Shiroka
Anëtari; Qamil Brovina
Kryetari; Hivzi Sylejmani,

DITA E TRETË E MARRJES NË PYETJE

Proqesverbal me 22.09. 1945

Gjykata e formuar si më parë në prezencën e Prokurorit Publik, të përfaqësuesve të pandehurve, sekretar Hasan Kryeziu

Ahmet Dërguti deklaron para prokurorit:

U prezantue i pandehubi Ahmet Dërguti, nga Rahoveci i mbiquajtur "Haj", intendent i Komandës së vendit në Rahovec, i cili deklaroi e tha: "Emnin Haj kamë marrë në konferencën e II-të, këtë emën ma ka dhanë Rifat Krasniqi, por për çfarë qëllimi nuk e di, mbasi nuk kemi zgjat punimin e komitetit nuk kam pas rast me kerkue shpjegimet prej këtij. Jemi betua në shtëpin e Halil Dërgutit në Rahovec. Betimin kemi ba mbi Flamurin e Shipnis pa yll, me gjithë që e di se Flamuri i Shipnis ka yllin. Mbi Flamur ka qenë musafi, mbi këtë alltia, se çfarë simbolli asht alltia nuk e di. Komiteti u formue me kerkue flamurin tonë, nëpunësat shqiptarë nëpër administrat mbasi në Kosovë asht shumica shqiptare. Unë kam qenë vet nëpunës.

Prokurori: A ka ushtar shqiptar nushtrin e Armatës Jugosllave I pandehuri" po, por ka qenë e nevojshme me pas edhe nëpër zyra. Me anën e konferencave kemi dasht me kerkue këto pika: nëpër konferenca të hapta, kemi ba organizatën e msheft për me parashtrua kërkesa haptazi. Për ndonji fuqi ushtarake nuk e di. Asnji material skemi marr as nuk kemi pas ku me i que. E quaj veten fajtor pse skam lajmru e pushtetin. Unë e di që ka pas organizata politike e frontit të përbashkët, por skam pas rast me folë nëpër konferenca të kësaj organizate, ma vonë mbasi na u dha flamuri ketë nevojë ska ndje as njeni nga ne. Ali Aksiqi mundet me kenë në Prishtinë, ka qenë njihere në mal, këte e ka que në mal një oficer i mobilizimit Beqir Hoxha dhe jo unë,

këtë gja e kam ndëgjue në Komandën e Vendit të Rahovecit. Vetëm njëherë ka kerkue organizata e Prizrenit me anën e Hoxhë Maliqit, prej Kadri Minushit disa shenime, Kadrija me tha mue që të baj këto shenime unë keto shenime i kam dorëzue Kadris, Kadrija ka qenë anëtar i KND të rrethit të Rahovecit si unë. Unë kam pas përsipër me kap lidhjen me Gjakoven, po kete lidhje nuk mujta me e ba mbasi mbas 10 dite u formue Komiteti shqiptar në Prishtinë. Xhem Met Siniqi asht i Rahovecit dhe jam takue me te i cili me dha njiheri nj letër dhe me tha: Ruaje, letra shkruante: punoni organizohuni lidhjen me Muharrem Bajraktarin e kemi, letrën e kishte nënshkrue Komona, Xhema e ka marr postën e Sylejman Haxhi Mustafës e ka dërgue në Prizren dhe e ka prue ketë letër që u tha më sipër. Unë këtë letër ja dorëzova Xhemës menjëherë. Në konferencën e Rahovecit Rifat Krasniqi ka mbajt një fjalim. Kryetar komiteti ka qenë Kajtaz Ramadani, sekretar i komitetit ka qenë Rifat Krasniqi. Rifati ka ngarkue Kajtazin që të merrte lidhjen me Drenicën. Rifati ka marr përsipër me ba lidhjen me Prizrenin dhe me formue komitetin komunal në Mamushë, Opterushë dhe në Krushë. Kadri Minushi ka marrë me formue komitetet komunale: Banjë, Caralluk dhe në Ostrozub. Sylejman Haxhi Mustafa nuk ka qenë në Komitetin tonë, leren e ka shkru me emnin e vet. Letrën e këndova në besim. Në dyqanin e Haxhi Sylejman Mustafës kam hy vetem njihere, atëherë asht bisedu për çështjen e komitetit. Ai tha qi ka qenë në mal para dy dite, në këtë moment erdhi në dyqan një prizrenjan, Rizaja tha se flitet qik anë ardhë 40 englezë mbi Dragash. Këto fjalë që u folën janë fjalë që e shkatrojn moralin e popullit. Dyqangjija ka pas besim tek unë. Vahidi me Rifatin kanë pas me formue komitetin në tri komuna. Unë kur kam dal prej dyqani të Sulejman Malltës me një Hajrullahun, tue u bashkua ma vonë me një infermier, i cili u da prej nesh dhe shkoi në spital. Me Xhemil Flukun nuk jam taku. Kjo ka qenë me 23-24 qershuer 1945. Unë kam qenë arkëtar i komitetit, por në ark nuk kam pas asnjë samtim, kemi dasht me kerkue ndihma nga populli. Unë nuk e di se me çfarë komiteti kemi pas lidhje. Rifat Krasniqi me ka tregue se asht takue me Adem Vocën nga Samodrazha në shtëpin e tij në Mamushë. Unë nuk jam njeri që mundem me ba vrasje dhe kërkuhi nuk më ka ndalue prej kryemjes së kësaj. Me Vahid Mustafën nuk kam pas asnjë kontakt para mbledhjes që ashtë

ba në shtëpin e Halim Dërgutit. Mua nuk më kujtohet që të ket folë Rifati për Mehdi Frashërin. Si intendent që kam qenë nëpër duar të mija kanë kalue afro 600.000 kg. Drithë, nuk kam ba asnjë abuzim ma të vogël, dy herë jam kontrollue. Rifati ka kerkue kuranin dhe kishte shkru diçka në letër. Rifati ashtë organizatori. Kemi hy me vullnetin tonë të plotë në këtë komitet. Rifati më ka thëanënë muajin mars se në Drenicë ka një radiostacion. Rifati për çështjen e radios ka folë me komitetin para të gjithëve. Radio kishte me shërbye per me i lidhë me Inqlitere, por me ke në Inqlitere nuk e di. Unë nuk e di që Kajtazi ka mujt me u lidhë me Drenicën dhe Prizrenin. Rifati ka thirrë neve për formimin e komitetit, por unë nuk jam interesua se kah ka ardhë direktiva për formimin e komitetit. Murati ka qenë anëtar i thjesht të këtij komiteti dhe nuk ka pas asnjë dinar. Unë kam deklarue se ai ka pas 300 napolona, por kjo nuk asht e vertet. Rifati ka kerkue prej komitetit 1.000 napolona e qi duhet të kishim mbledh prej tregtarëve, këto pare kishin me u shpenzue për nevojat e komitetit, si shpërblim udhëtimit të disa anëtarëve të komitetit, por nuk e di që të ketë folë për me ble një radio me këto të holla. Kajtazi ka thanë se nuk duan pare. Hysen Bajrak Aksiqin kam thirr në komitet dhe Murat Tahir Agën. Unë kam ndëgjue prej Sylejman Malltës që disa njerëz të komitetit kanë shkue te Muharrem Bajraktari, po prej këtij kam ndegjue për Adem Vocën edhe për një radiostacion në Drenicë. Muharrem Gashi ka qenë nëpunës i Këshillit të

Rrethit ka pas me dorëzue gjanat ushqimore komandës së vendit. Njiheri kam konstatue se 40, 50 kg lesh ishte ma tepër simbas librave tintendancës dhe këto kam kthye këtij. Skam dasht me ba abuzim. Unë e di se Muharrem Bajraktari ka luftue kundër okupatorit dhe kundra partizanve. Mbrenda 3-4 muajve nuk jemi mbledhë asnjë ditë.

Pyetjet e gjyqëtarëve:

Kryetari: prej marsit deri në qershor ka ekzistue komiteti.


Ahmeti: po ka ekzistue

Gjyqëtar Kola: atëherë ka ka ekzistue tre muaj.

Ahmeti: pardon, komiteti ka ekzistue 11 ditë.

Avokat Pallaska: Kush e ka prue flamurin

I pandehuni: unë, Mbas 10 dite neve kemi konstatue se nuk ka për shka të ekzistonte ma komiteti. Sheh Muhedini nuk i ka organizue komitetet nëpër komuna dhe katunde. Në mbledhjen e komitetit e di se ka qenë njëfar ngatërrese, nuk e di me siguri por me duket se ishte puna: alltia mbi musafin. Alltija asht simbol i luftës, por unë skam pas qëllim lufte kundra pushtetit populluar. Kajtazi nuk e ka plotësue detyrën si kryetar i komitetit, Kadrija nuk e ka plotësue krejtësisht detyrën. Eqrem Hadin nuk e njomi, por e di që ka qenë kryetar i gjyqit dhe që Rifati ka qenë dhëndri i tij, por nuk kemi folë me Rifatin për Eqrem Hadon. Vait Mustafa nuk e deshti me ba betimin, por mbas insistimit tonë asht betua s'bashku me ne, mbasandaj na tha se qysh në kohën e okupatorit kenka betua në një vend. (Vijon)



E rrallë

Zbulohet një smerald i veçantë në Zambia të Afrikës

Prodhuesi më i madh i gurëve të gjelbër në botë, Gemfield, ka zbuluar një kristal smeraldi prej 5,655 karatësh në njërin nga minierat në Zambia. Kompania ka bërë me dije se guri i cili peshon pak më shumë se 1 kilogram është gjetur në minierat e Gemfield-it në Kagem, raporton "CNN".



BARSOLETA E DITËS



Pijaneci: I nderuar polic, Hëna është atje lart? Polici: Nuk e di, se nuk jam nga kjo lagje!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Një fëmijë shihet duke ecur në baltë në kampin afër qytetit të al-Arishah në krahinën veriore të Sirisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Britaniku shet ajër të pastër të Alpeve të Zvicrës

Çdokush që ka kaluar kohë në alpet zvicerane e di shumë mirë se sa i pastër dhe i freskët ndihet ajri. Por një britanik ka vendosur të bëjë diçka të jashtëzakonshme, pasi po përpiqet të përfitojë nga ky aset natyral zviceran. Ai po praktikon idenë e tij duke mbushur dhe shitur ajrin e vërtetë malor për një çmim të volitshëm.



Kompania e biznesmenit John Green, e cila vepron online përmes mountainairfromswitzerland.com, shet ajrin e tij zviceran në shishe me një kosto që ka vlerë 97 dollarë për 500 ml.

 <p>DASHI Nuk duhet të ndikoheni nga fjalët e të tjerëve për një projekt të caktuar. Nëse duhet të vendosni, jeni të vetmit që mund ta bëni këtë gjë.</p>	 <p>DEMI Tashmë ka ardhur koha që të merreni me disa takime të rëndësishme që keni kohë që i keni prenotuar. Askush nuk po e kupton ankthin tuaj.</p>	 <p>BINJAKËT Edhe pse ju ka kapur paniku lidhur me një çështje të caktuar është mirë të mos e shfaqni. Tregohuni të qetë dhe të gjithë do të mendojnë se e keni situatën në kontroll.</p>	 <p>GAFORRJA Përvoja do t'ju vijë në ndihmë sot të diini nga një ngërç i papritur. Nëse nuk do të ishit mësuar me këto situata mund ta pësonit.</p>	 <p>LUANI Nga ana sentimentale keni mjaft dyshime në lidhje me raportin tuaj. Duhet t'i qartësoni sepse kështu do të vuani veç ju.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Keni filluar të hapeni me të tjerët dhe të krijoni njohje të reja. Keni kuptuar që qëndrimi vetëm ju bën keq shpirtërisht.</p>
 <p>PESHORJA Sot do të zgjoheni me humor të mirë që në mëngjes. Partneri është shumë i pranishëm në ditën tuaj dhe nuk do t'ju cenojë asnjë fjalë e thënë për keq.</p>	 <p>AKREPI Gjërat dhe situatat që nuk ju pëlqejnë sot mjafton t'i hidhni pas krahëve. Nëse familja ka nevojë për ju sot duhet t'i përgjigjeni menjëherë.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot do të ndiheni në paqe me veten dhe ambientin që ju rrethon. Gjithçka po shkon siç e kishit parashikuar dhe mbrëmja do t'ju gjejë të çlodhur.</p>	 <p>BRICJAPI E keni humbur ndjesinë e të qenit të përkëdhelur dhe për këtë gjë do ta ndjeni shumë mungesën sot. Ndiheni të mposhtur nga vetmia.</p>	 <p>UJORI Gjithçka që i takon punës suaj duhet të zërë vetëm orarin e caktuar. Mos e ngarkoni ditën tuaj me gjëra që janë komplet sekondare për ju.</p>	 <p>PESHQIT Sot do t'ju kontaktojnë një person që në të shkuarën ju ka ndihmuar me punë dhe çështje financiare. Jeni drejt një bashkëpunimi të ri.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	LYON - HOFFENHEIM	1	MAN CITY - SHAKHTAR DONETSK	4+	BENFICA - AJAX	3+
-------------------	-------------------	---	-----------------------------	----	----------------	----

Feronikeli - Prishtina, 'beteja' për vendin e parë

Dy skuadrat më të mira në këtë edicion të elitës së futbollit, Feronikeli dhe Prishtina, përballen sot në Drenas nga ora 13:30. Synim i vendësve, sipas sulmuesit Astrit Fazliu, është fitorja, kurse kapiteni i mysafirëve, Armend Dallku, ka bërë me dije se këtë ndeshje do të luajnë ashtu siç i ka hije Prishtinës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Derbi i mbetur i xhiros së dhjetë në IPKO Superligën e Kosovës në mes të Feronikelit dhe Prishtinës do të zhvillohet sot (e mërkurë). Kjo ndeshje pritet të jetë më shumë se një derbi, pasi skuadrat në fjalë do të "luftojnë" edhe për pozitën e parë në renditjen e klasifikimit. Aktualisht "Nikli" ka dy pikë më shumë, por një fitore e Prishtinës do ta zbriste ata nga fronin. Sulmuesi Astrit Fazliu ka thënë për "Epokën e re" se Feronikeli do të triumfojë në ndeshjen kryesore të sezonit ndaj Prishtinës. "Kjo ndeshje nuk është vendimtare për titull, por ka rëndësi të madhe për dy klubet, për faktin se secili prej tyre synon ta marrë maksimumin për të qenë sa më mirë me pikë në tabelën e klasifikimit, prandaj edhe interesimi i shikuesve besoj se do të jetë i madh. Pres përkrahje edhe më të madhe nga tifozët tanë në këtë ndeshje dhe në fund do t'i gëzohemi fitores", ka thënë Fazliu. Ndërsa mbrojtësi dhe kapiteni i Prishtinës, Armend Dallku, e vlerëson ndeshjen e radhës shumë të rëndësishme për të dyja skuadrat, por ai ka thënë se "bardhekaltrit" nuk e synojnë me çdo kusht fitoren, por se do të paraqiten ashtu siç i ka hije Prishtinës. "Për ne është ndeshje e radhës. Normalisht motivi nuk mungon, sepse është ndeshje e madhe dhe nuk ka nevojë për shumë motivim nga trajnerët apo nga anash. Presim rezultat pozitiv, natyrisht duke u bazuar në ndeshjet e fundit, ku kemi pasur seri pozitive dhe na gëzon fakti, megjithëse po flitet shumë që ne nuk po shënojmë, hiç ndeshjen me Drenicën, në ndeshjet e



tjera kemi shënuar nga 2 apo 3 gola, duke bërë fazë shumë të mirë ofensive dhe në momentet e duhura po vijmë te shanset për gol. Kjo ndeshje nuk do të jetë përjashtim dhe ne kemi qëllim të vetëm fitoren, të luajmë futboll e t'i tregojmë cilësitë tona dhe që tërë Kosovës që po e pret këtë ndeshje, t'i paraqitemi ashtu siç i ka hije Prishtinës që lufton për vend të parë", ka thënë Dallku për faqen zyrtare të klubit kryeqytetas. Feronikeli pozicionohet në pozitën e

parë me 32 pikë të grumbulluara, duke regjistruar dhjetë fitore, dy barazime dhe një humbje. Ndërsa skuadra "bardhekaltrë" është e dyta me dy pikë më pak, kurse ka regjistruar nëntë fitore, tri barazime dhe një humbje.

Sot takohen:

13:30 Feronikeli - Prishtina
13:30 KEK-u - Ferizaj

SHKURT

Më 1 janar afati kalimtar në basketboll

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar të gjitha klubet se afati kalimtar dimëror fillon më 1 janar dhe përfundon më 11 janar. Klubet që planifikojnë të bëjnë transferime për sezonin e dytë duhet të bëjnë planifikime të mëhershme, pasi tashmë dihet data dhe perioda kohore për realizimin e transferimeve.

Spanja nuk e lejon flamurin dhe emrin e Kosovës në Botërorin e Karatesë

Emrat e karateistëve të Kosovës janë paraqitur në listën e pjesëmarrësve të Kampionatit Botëror të Karatesë që mbahet në Madrid të Spanjës, por në listën e gjatë në sajtin zyrtar (sportdata.org) nuk figuron askund emri i Kosovës. Kosova do të paraqitet me 13 karateistë në botërorin për seniorë, që pritet të garojnë pa simbole të vendit. Se trajtimi ndaj garuesve të Kosovës nuk është i njëjtë me atë ndaj garuesve të tjerë dëshmon lista e publikuar e pjesëmarrësve. Në vend të emrit "Kosova", figuron shkurtesa "WKF5", një shkurtesë e Federatës Botërore të Karatesë për t'i identifikuar karateistët nga Kosova. Nga organizatori nuk janë dhënë informata, kurse drejtuesit e Federatës së Karatesë së Kosovës kanë bërë të ditur se po përballen me telashe politike në botërorin që nis të martën në Spanjë.

Wengeri, pasardhës i Gattuos te Milani

Pasardhës i trajnerit aktual të Milanit, Gennaro Gattuso, pritet të jetë Arsene Wenger. Lajmi është bërë me dije nga revista prestigjioze "France Football", e cila bënë me dije se në javët e fundit ka pasur shumë kontakte mes drejtuesve të Milanit dhe ish-trajnerit të Arsenalit. "Do të jem diku në ndonjë skuadër në fillim të vitit tjetër, por nuk e di se ku. Kam pushuar dhe e kam ndjekur futbollin. E ndiej mungesën e tij", ka thënë Wengeri, i cili pëlqehet edhe nga Bayern Munchen dhe Real Madridi.

Ja çiftet e rethit të dytë në Kupën e Kosovës

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Të martën është tërhequr shorti për rrethin e dytë (1/16) të finaleve për Digitalb Kupën e Kosovës në Futboll. Në këtë rreth u përfshinë edhe skuadrat e IPKO Superligës, e ku tri çifte do të jenë pikërisht me skuadrat e elitës. Ndeshjet e këtij rrethi do

të luhen më 27 nëntor. Prishtina e nis mbrojtjen e titullit të Kupës me përballjen ndaj Drenicës, kurse ndeshja më interesante do të jetë ajo në mes të Trepçës '89 dhe Llapit. Çiftet e rethit të dytë: KEK-u - Flamurtari, Bashkimi (K) - Vëllaznimi, Sharri - Gjilani,

Minatori - 2 Korriku, Istogu - Ramiz Sadiku, Drenasi - Ballkani, Kika - Vushtrria, Dukagjini - Arbëria, Vitia - Drita, Lugu i Baranit - Liria, Vllaznia (P) - Besa, Ferizaj - Vllazëria (Zh), Fushë Kosova - Onix, Drenica - Prishtina, Trepça '89 - Llapi, Trepça - Feronikeli.



Jeton Beqiri do ta ndajë drejtësinë në LE "Minsk 2019"

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Gjyqtari ndërkombëtar i pingpongut, Jeton Beqiri, ka shënuar një tjetër arritje në karrierë. Beqiri nga Unioni Evropian i Pingpongut (ETTU) është përzgjedhur për ta ndarë drejtësinë në Lojërat Evropiane Minsk 2019, të cilat

mbahen prej 21-30 qershorit në Minsk të Bjellorusisë. Krahas Lojërave Evropiane, Beqiri është bërë anëtar i plotë i Komitetit të Rangimit të ETTU-së për Evropë për periudhën 2018-2020 si dhe është përzgjedhur gjyqtar suprem ndërkombëtar për

ndeshjen kualifikuese të Kampionatit Evropian 2019 në mes të Turqisë dhe Danimarkës, takim që luhet në muajin nëntor. Beqiri ishte gjyqtar i pingpongut edhe në Lojërat Olimpikë "RIO 2016", në të cilat Ekipi Olimpik i Kosovës debutoi me medalje të

artë falë xhudistes Majlinda Kelmendi. Ekipi i Kosovës do të përfaqësohet edhe në Lojërat Evropiane Minsk 2019, në të cilat synon medaljen e dytë, pas xhudistes Nora Gjakova, që kishte fituar medaljen e bronzitë në Baku 2015.



Juve kërkon sërish fitore ndaj Unitedit për vendin e parë në grup

TORINO, 6 NËNTOR - Juventus - Manchester United do të luhet të mërkurën, më 7 nëntor 2018, në orën 21:00, në stadiumin "Allianz" të Torinos. "Zonja e Vjetër", udhëheqëse e grupit H, me pikë të plota, do t'i presë "Djajtë e Kuq" në ditën e katërt të fazës së grupeve të Ligës së Kampionëve. Për bardhezinjtë nuk do të jetë e mjaftueshme vetëm për ta marrë kualifikimin matematikor për në raundin e dytë, atë me eliminim të drejtpërdrejtë të këtij kompeticioni, dy ndeshje para përfundimit të fazës së grupeve. Në rast të fitores, Juventus gjithashtu, do ta ketë sigurinë e vendit të parë në grup. Allegri duhet ta konfirmojë modulin 4-3-3 të ndeshjeve të fundit, me disa ndryshime të detyruara për shkak të mungesave të shumta. Në mesfushë Khedira mund të luajë nga minuta e parë, si edhe Mandzukiqi në sulm. Chiellini është rikthyer, ndërsa Bernardeschi nuk do të jetë gati. Për t'u vlerësuar janë Cancelo, Matuidi dhe Douglas Costa: të tre ende nuk janë të sigurt për të startuar nga fillimi. De Sciglio është një kandidat për trashëgiminë e mbrojtësit portugez. Disa informacione mund të nxirren nga seancat e trajnimit të Mourinhos, të cilat konfirmojnë treshen Martial, Pogba dhe Sanchez, pas sulmuesit të vetëm, Lukaku. Herrera kthehet në mesfushë, së bashku me Matiqin, pas testit të mirë në Premierë Ligë. Juventus dhe Manchester Unitedi deri më tani janë përballur 13 herë, me një bilanc prej gjashtë fitoresh të bardhezinjve (e fundit në ndeshjen pararendëse), pesë fitore të "Djajve të Kuq" dhe dy barazime.



GRUPI E			GRUPI G		
21:00 Bayern Munchen - AEK Athens			18:55 CSKA Moscow - Roma		
21:00 Benfica - Ajax			21:00 Viktoria Plzen - Real Madrid		
Tabela			Tabela		
1. Ajax	3	7 pikë	1. Real Madrid	3	6 pikë
2. Bayern M.	3	7	2. Roma	3	6
3. Benfica	3	3	3. CSKA M.	3	4
4. AEK Athens	3	0	4. Viktoria Plzen	3	1
GRUPI F			GRUPI H		
21:00 Lyon - Hoffenheim			18:55 Valencia - Young Boys		
21:00 Manchester City - Shakhtar Donetsk			21:00 Juventus - Manchester United		
Tabela			Tabela		
1. Manchester City	3	6 pikë	1. Juventus	3	9 pikë
2. Lyon	3	5	2. Manchester United	3	4
3. Hoffenheim	3	2	3. Valencia	3	2
4. Shakhtar Donetsk	3	2	4. Young Boys	3	1

Golden State regjistron fitoren e tetë radhazi

OAKLAND, 6 NËNTOR - Kampionët e Golden State vijnë marshimin e tyre në Konferencën e Perëndimit, duke mundur 117-101 Memphisin, suksesi i tetë radhazi për basketbollistët e Warriorsit. Një ndeshje me rivalitet vetëm në pjesën e parë, pasi më tej gjithçka foli për vendësit, që u shkëputën deri në 25 pikë e korren një fitore të merituar. Thompsoni me 27 pikë e Duranti me 22 ishin dy shënuesit më të mirë për Golden Staten, ndërkohë



që 38 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Fiton edhe skuadra e Denverit, ndjekësja më e afërt e Warriorsit në Perëndim, që mundi 115-107 Bostonin, falë 48 pikëve të

REZULTATET	
Detroit - Miami	115-120
Indiana - Houston	94-98
Orlando - Cleveland	102-100
New York - Chicago	115-116
Oklahoma - New Orleans	122-116
Denver - Boston	115-107
Utah Jazz - Toronto	111-124
Golden State - Memphis	117-101
Clippers - Minnesota	120-109

Murrayt. Fitorja e pestë radhazi edhe për Oklahomën, që ka dalë nga kriza, duke mundur 122-116 New Orleansin, sfidë në përgjithësi e komanduar nga basketbollistët e Thunderit. George realizoi 23 pikë për Oklahomën, ndërkohë që një ndihmë të madhe dhanë lojtarët e stolit, që realizuan 46 pikë.

SHKURT

Futbollisti shqiptar ia shpëton jetën kundërshtarit

Mesfushori i kombëtares shqiptare, Kamer Qaka, ka bërë një heroizëm në ndeshjen e fundit ndaj Universiteta Kraiova në kampionatin rumun. Ai i ka shpëtuar jetën kundërshtarit, i cili mbeti i shtrirë në tokë pas një përplasje në fushën e lojës. Valentin Mihaila mbeti pa ndjenja në fushë pas një goditje në nofull, ndërsa Qaka jo vetëm ishte i pari që reagoi duke thirrur mjekët të ndërhyjnë, por edhe shkoi me shpejtësi të 18-vjeçari dhe e ktheu me shpejtësi në krah. Një lëvizje e tillë është e këshillueshme në raste të tilla pasi ndihmon në lirimim e frymëmarrjes e cilësohet si vendimtare në rastet e para dhe Qaka veproi para mbërritjes së mjekëve pranë lojtarit të shtrirë pa ndjenja. Për fat të mirë, Mihaila u dërgua në spital dhe gjendja e tij është stabilizuar. Ndaj me siguri Qaka ka dalë i lumtur nga fusha e lojës edhe pse ekipi i tij u mund me shifrat 3-0. Në jetë ka gjëra më të rëndësishme se një ndeshje futbollit.

Jamesi dëshiron rikthimin në Real

Situata nëpër të cilën po kalon klubi gjerman Bayern Munchen dhe anashkalimi që po i bën trajneri Niko Kovaç duket se janë të padurueshme për yllin James Rodriguez. Mediet në Gjermani raportojnë se mesfushori kolumbian po dëshiron rikthimin në Real Madrid, pasi është i pakënaqur në skuadrën e Bayernit. Siç dihet, futbollisti në fjalë është i huazuar të gjiganti "bavarez", i cili ka të drejtë blerje për 64 milionë euro.

Realit në janar e dëshiron Icardin

